

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“Ales Real Estate” Sh.p.k**

*I. THEMELIMI*

**NENI 1  
Ortakët themelues**

Shoqëria krijohet nga ortaku themelues:

- Z.Eraldo Duro, shtetas shqiptar, lindur më 27/09/1990 në Ersekë, Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi J00927064P, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

*II. EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE - OBJEKTI*

**NENI 2  
Emertimi**

Shoqëria emertohet **“Ales Real Estate” Sh.p.k**

**NENI 3  
Forma juridike**

Forma juridike do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per shoqëritë Tregtare”.

**NENI 4  
Selia**

4.1 Shoqëria **“Ales Real Estate” Sh.p.k** e ka selinë e saj në adresën: Tirane, Njësia Administrative 14, Rruga Teodor Keko, Pallati Ales, Kati 1-re, njësia nr 1, kodë postar 1001.

4.2 Shoqëria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund të kryejë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet filialeve, degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjensite e saj, të cilat janë krijuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe do të veprojnë nën mbikqyrjen e Administratorëve të **“Ales Real Estate” Sh.p.k**

**NENI 5  
Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

5.1. Shoqëria **“Ales Real Estate” Sh.p.k** ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislati shqiptar.



5.2. Veprimtaria e Shoqerisë “**Ales Real Estate**” **Sh.p.k** do të ketë për objekt: Veprimtari ekonomike ne fushe e real estate (pasurive te paluajtshme), qe ka te bej me negocime, ndermjetesime, perfaqesime te te treteve ne fushen e real estate si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar. Shitje, blerje, dhenie me qira te te gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme, brenda dhe jashte vendit, si dhe çdo transakcion tjetër ne funksion te permbushjes se objektit te veprimtarise ne fushen e real estate, midis personave fizike, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe çdo veprim tjetër i ligjshem qe ka te beje me pasurite e paluajtshme. Veprimtari ekonomike ne fushe e turizmit, nepermjet ngritjes, operimit dhe adminstrimit te strukturave turistike pritese (akomoduese) dhe te gjitha sherbimet direkt apo indirekt te lidhura me to, si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar; Marrja dhe/ose zhvillimi, kryerja ose ofrimi i sherbimeve ne fushe e real estate (pasurive te paluajtshme), qe kane te bejne me marketing, marredhenieve me publikun, ekspertize shitje apo qiradhenie apo operim/administrim turistik, menaxhimi, sherbime te studimit te tregut, sherbime te pas shitjes, ndjekja e pagesave te klienteve. Vleresimi i te gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme (urbane, rurale, komerciale, administrative, shoqerore, turistike, rezidenciale etj.) dhe aseteteve (te luajtshme apo te paluajtshme) ne funksion te tyre; Administrimi i bashkepronesise ne ndertesa, ne resorte apo struktura turistike dhe ne komplekse rezidenciale. Shoqeria mund edhe te jape garanci reale dhe/ose personale, te vendose pengje, te dale dorezanese apo te vendose hipoteke edhe ne favor te te treteve.

5.3 Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;

5.4 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

5.5 Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese se Pergjithshme.

### *III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA*

#### **NENI 6**

#### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

#### **NENI 7**

#### **Kapitali i Shoqerise**

7.1 Kapitali themeltar i shoqerise “**Ales Real Estate**” **Sh.p.k** perfaqesohet nga 1 (nje) kuote me vlere totale 100,000 (njeqind mij) leke e cila nuk eshte paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:

- Z.Eraldo Duro: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere të përgjithshme 100,000 (njeqind mije) leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.



## **NENI 8**

### **Asambleja e Pergjithshme**

Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet qe ligji apo Statuti ia rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Pergjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise "Ales Real Estate" Sh.p.k

8.2 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- ndryshimit të Statutit;
- riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likuidimi, shnderrimi i shoqerise;
- zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre;
- emerimi dhe shkarkimi i Aministratorit;
- emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

## **NENI 9**

### **Organet drejtuese**

9.1. Organet drejtuese të Shoqerisë janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

## **NENI 10**

### **Administratori i Shoqërisë**

10.1 Shoqeria administrohet nga Administratori, person fizik qe mund te jetë ose jo ortak i Shoqërisë.

10.2 Administratori eshte të detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin " Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Statutin, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

10.3 Administratori i Shoqërisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje ne detyre per një kohë prej 5 (pese) vjetesh.

10.4 Administatori e pare te shoqërisë emerohet:

- Z.Eraldo Duro, shtetas shqiptar, lindur më 27/09/1990 në Ersekë, Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi J00927064P, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

Nënshkrimi i administratorit



10.5 Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njuh ligji dhe Statuti i Shoqerise.


## **NENI 11**

### **Ligji i zbatueshem dhe mosmarreshjet**

- 11.1 Per sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i behet legjislacionit shqiptar ne fuqi.  
11.2. Per te gjitha mosmarreshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompentent do te jete Gjkata e Rrethit Gjyqesor Tirane.  
11.3. Ky dokument redaktohet ne 3 (tre) kopje origjinale.  
Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaku themelues

**ORTAKET THEMELUES**

**Z. Eraldo Duro**



**Data: 06/09/2022**